



Projekti - Shtrirja e ViP Dinarika në Regjionin Shqipëri - Kosovë - Programi Ndërkufitar Numri i kontratës: 2018/395-022

Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të
Fondit për Zhvillim Komunitar -CDF dhe Komunës së Gjakoves, lidhur me Mbikëqyrjen e
Punimeve për ndërtimin e Ballkonit Panoramik në Gjakove

Ne vazhdim: Palët janë dakorduar si më poshtë:

Kjo marreveshje e re e zëvendëson marreveshjen me Komunen e Gjakoves e nënshkruar me date 30 Tetor 2020 dhe të gjitha obligimet barten në Marreveshjen e Re.

Informata mbi projektin

Projekti "Shtrirja e ViP Dinarika në Regjionin Shqiperi - Kosove" financohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar me Shqipërinë dhe implementohet nga: Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF-Udhëheqësi i Projektit), Kosovë, Partneri: bashkë-aplikuesi: Fondi Shqiptar për Zhvillim në Shqipëri.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i aktiviteteve ndërkufitare ekonomike përmes modeleve unike të turizmit të qëndrueshëm duke u bazuar në vlera natyrore, tradicionale dhe kulturore, duke i promovuar karakteristikat e përbashkëta të rajonit.

Objektivat specifike:

Zhvillimi ViP Dinarika, shtigjeve në distanca të gjata dhe të pakove turistike që lidh komunitetet malore dhe akterët e turizmit në rajonin e synuar për ngritjen e vlerave dhe pasurive unike natyrore dhe trashëgimisë kulturore-historike, ngritja e vetëdijes për përfitimet ekonomike, mjedisore dhe sociale të shtigjeve në distanca të gjata, ngritja e atraktivitetit dhe konkurrencës së ofertës turistike në Bjeshkët e Nemuna.

Aktivitetet kryesore:

Aktiviteti Nr.1: Përmirësoj dhe intervenoj në infrastrukturë në shkallët e vogël turizmit; Aktiviteti Nr.2: Zhvillimi i ofertave turistike- brendi ViP Dinarika; (lidhur me R2 & R3) Aktiviteti Nr.3: Hartimi dhe ndjekja GPS e rrugëve në rajonin ndërkufitar; (lidhur me R6), Aktiviteti Nr. 4: Programi i Përbashkët i Qasjes në Treg; (lidhur me R6), Aktiviteti Nr. 5: Ngritja e kapaciteteve të klubeve alpiniste ALB & KOS; (lidhur me R4), Aktiviteti Nr.6: Promovimi, ngritja e ndërgjegjësimit dhe marketingut të destinacionit. (lidhur me R7).

Lokacioni i Projektit:

Kosovë: Bjeshkët e Nemuna, Komunitat: Gjakovë, Deçan, Junik dhe Gjakovë.
Shqipëri: Komunitat Rajoni Kukësit dhe Rajoni i Lezhës.

Partneret relevant: Komunitat e Projektit, Zyra Rajonale e Menaxhimit të Parkut Kombëtar Kosovë, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Bizneset Private (operatorët turistikë, shitësit e turizmit etj.).

Qëllimi:

Projekti: Ndërtimi i Ures Tibetiane:

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është paraparë që të ndërtohen dy ballkone panoramike një ne Komunen e Pejës dhe një ne Komunen e Gjakovës.

Duke marrë parasysh pengesat ligjore/ apo kontekstin ligjor nga Zyra e Parkut Nacional për ndërtimin e ballkonit në lokacionin Rrasa e Kosharës, në Gjakovë, në këtë zonë sipas parkut nacional nuk lejohet asnjë ndërtim.

Duke marrë parasysh situatën, CDF në marrëveshje me zyrtarët Komunal në Gjakovë duke përfshirë edhe zyrën e Kryetarit, palet në këtë marrëveshje dakordohen tutje:

Te zëvendësohet produkti i projektit apo Ballkoni Panoramik i caktuar paraprakisht nga Komuna e Gjakovës për gjatë shtegut Via Dinarica (tek Memoriali në Kosharë) me ndërtimin e ures tibetiane:

Ndryshimet në Marrëveshjen e Mirekuptimit të nënshkruar me datën 25.08.2019 me nr. protokollin: 01-413/01-36413 dhe 30 Tetor 2020 me nr. protokollin 01-413/01-27965.

- Shkeputja e marrëveshjes me Kontraktorin NGP-ing për ballkonin panoramik në Gjakovë në vlerë 5,503.80 EUR;
- Obligimet financiare të ***marrëveshjes me Komunen e Gjakovës e nënshkruar me datë 30 Tetor 2020 në vlerë financiare 10.000.00 EUR nuk vlen dhe të gjitha obligimet barten në Marrëveshjen e Re.***
- ***Obligimet financiare në Marrëveshjen e re bartin shumën 10.000.00 EUR (për ballkonin panoramik në Gjakovë në vlerë 5,503.80 EUR) si dhe bartin shumën e mbetur 4,496.20 si dhe obligohen të paguajnë 8.878.00 EUR shtesë për ndërtimin e ures tibetiane në Gjakovë.***
- ***Totali i detyrimeve financiare të Komunes së Gjakovës janë 18.878.00 EUR.***

Përgjegjësit e palëve (individualisht në këtë marrëveshje

Fondi për Zhvillim Komunitar -CDF:

- Merr pëlqimin e Delegacionit Evropian në Shqipëri për ndryshimet (zëvendësimin e Ballkonit Panoramik me Uren Tibetiane) dhe ben ndryshimet në Projekt si dhe në buxhet;
- Zhvillon dokumentacionin për Studimin e Fizibilitetit;
- **Studimi, Dizajni dhe Ndërtimi i Ures Tibetiane do të bëhet në kuadër të projektit Via Dinarica është paguar nga CDF në vlerë 2.450.00 EUR**
- **Pjesa tjetër e financimit do të bëhet në kuadër të projektit Ndërtimi i Ures Tibetiane Via Dinarica përmes CDF -it do të jete në vlerë 26.905.00 EUR.**
- Hap tender për ndërtimin e ures tibetiane sipas kontratës me Programi Ndërkufitar numri i kontratës: 2018/395-022 em Addendum 02;
- Sipas nevojës, i ofron mbështetje logjistike komunës së Gjakovës për mbikëqyrjen e punimeve;
- I kryen pagesat për punët e kryera, pas aprovimit të Mbikëqyrësit të Komunës së Gjakovës dhe Menaxherit të Programit në CDF;
- Merr pjesë në mbikëqyrjen e punimeve në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Komunës.
- Pergadite reporte progresi për punët për Delegacionin Evropian në Shqipëri.
- ***Totali i detyrimeve financiare se CDF janë 29,355.00 EUR (2.450.00 EUR për studim fizibiliteti si dhe 26.905.00 EUR për ndërtimin e ures.***

Komuna e Gjakoves:

- **Obligimet financiare ne Marreveshjen e re bartin shumen 10.000.00 EUR** (per ballkonin panoramik ne Gjakove ne vlere 5,503.80 EUR) si **dhe bartin shumen e mbetur 4,496.20 si dhe obligohen te paguajne 8.878.00 EUR shtese per ndertimin e ures tibetiane ne Gjakove.**
- **Totali i detyrimeve financiare te Komunes se Gjakoives jane 18.878.00 EUR.**
- **Pas nenshkrimit te kesaj marreveshje me CDF dhe ben pagesen tek llogaria e CDF ne vlere 18.878.00 EUR gjate muajit Qeshor 2021 sipas fakturave dhe raportit te progresit.**
- Siguron lejen adekuate per ndertimin e Ures Tibetiane sa me shpejt gjate muajit Nentor;
- Emëron stafin kompetent komunal për mbikëqyrje profesionale gjatë realizimit të punimeve dhe siguron mbikëqyrje të vazhdueshme gjatë tërë kohës së ekzekutimit në terren;
- Përgatitë raporte progresi rreth punëve të kryera që nënkupton aprovimin apo mos aprovimin e punëve të kryera;
- Bashkëpunon me stafin e CDF gjatë tërë kohës.
- Aprovon dhe nënshkruan situacionet e punëve të kryera sipas paramasës dhe kontratës.
- Siguron mirembajtjen e ures ne te ardhmen.

Aneksat:

- Dokumentacioni tenderit
- Hapja publike
- Oferta teknike
- Oferta financiare
- Vleresimi i tenderit
- Kontrata per ndertimin e ures Tibetiane

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind gjatë zbatimit të këtij bashkëpunimi në mes të palëve do të zgjidhet me marrëveshje dhe në rast të dështimit atëherë lënda do të dërgohet tek Gjykata kompetente në Kosovë.

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshjeje Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët.

Pjese integrale e kësaj marrëveshje janë:

- Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar me datën 25.08.2019 me nr. protokoli: 01-413/01-36413;
- Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar me datën 30 Tetor 2020 me nr. protokoli 01-413/01-27965.

Nënshkrimi dhe vula

Nermin Mahmuti,
Drejtoreshë Ekzekutive, CDF
Data:

Nënshkrimi dhe vula

Ardian Gjini Kryetar,
KK Gjakove
Data:

